



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 13/17
Prishtinë, më 20.12.2017, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Ali Lajçi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku dhe Enver Hoti.

Munguan: Dardan Molliqaj, Mytaher Haskuka, Blerim Kuçi dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Fatmir Gashi, zëvendësministër i Financave, Lulzim Rafuna, këshilltar politik i ministrit të Financave, Salvador Elmazi, drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Xheladin Hoxha, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale, Fehmi Hyseni, drejtor i Drejtorisë për Mbështetjen e Komisioneve Parlamentare.

Pjesëmarrës tjerë: Milaim Zeka, deputet.

Pjesëmarrës nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurie Canolli.

Mbledhjen e kryesoi, Lumir Abdixhiku, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Shqyrtimi i raporteve me rekomandime të komisioneve tjera të përhershme, lidhur me Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, si dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.**

Kryetari, tha se në kemi marrë raportet me rekomandime të komisioneve tjera të përhershme, të cilat nuk kanë vërejtje në amendamentet e propozuara në Projektligjin e Buxhetit 2018. Mirëpo, në kemi edhe dy propozime të reja. Propozimi i parë është një sugjerim i administratës së Kuvendit, për nevojën e ndryshimit të nenit 24 të pjesës tekstuale, që ka të bëjë me hyrjen në fuqi të ligjit. Propozimi është që të ndryshohet neni 24, me tekstin si vijon: “Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me efekt financiar, më 1 janar 2018”. Ndërsa, çështja e dytë ka të bëjë me një amendament që kemi pranuar nga deputeti Milaim Zeka.

Fatmir Gashi, tha se në bazë të Kushtetutës, ligji hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nëse në ligj nuk përcaktohet ndryshe.

Naser Osmani, tha se viti fiskal fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor, kështu që ligji duhet të hyjë në fuqi më 1 janar 2018.

Lulzim Rafuna, theksoi se është një ligj specifik, për dallim prej ligjeve tjera, dhe këtu asnjë cent nuk mund të fillojë të ndahet apo shpenzohet, pa hyrë ligji në fuqi. Zbatimi i këtij ligji fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor. Kushtetuta thotë se ligji hyn në fuqi 15 ditë, në qoftë se nuk përcaktohet ndryshe me ligj. Ne kemi pasur raste kur e kemi rregulluar që ligji hyn në fuqi në momentin e miratimit nga Kuvendi, pavarësisht kur publikohet në Gazetën Zyrtare.

Xheladin Hoxha, sqaroi se ne e kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese, kur është vlerësuar kushtetutshmëria e Ligjit për institucionet bankare, mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo-bankare, i cili ka thënë tekstualisht se ligji nuk mund të hyjë në fuqi, pa u publikuar në Gazetën Zyrtare. Prandaj, sugjerimi ynë është që ligji hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare, ndërsa efektet financiare të fillojnë më 1 janar 2018.

Naser Osmani, tha se pa hyrë ligji në fuqi, nuk mund të bëhen pagesa apo duhet vendosur një nen, ku thuhet se zbatohen rregulla sipas Ligjit për menaxhimin të financave publike.

Xheladin Hoxha, sqaroi se kjo është praktikë e të gjitha shteteve, ku thuhet se efektet financiare të ligjit fillojnë nga 1 janari, edhe pse ligji mund të miratohet më 1 dhjetor, 1 tetor apo 15 nëntor, dhe këtë nuk e ndalon Kushtetua, por hyrja në fuqi duhet të jetë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Naser Osmani, më falni, por nuk po e kuptoj juridikisht, sepse të publikohet ligji në shkurt e të ketë efektin prej 1 janarit.

Kryetari, tha se unë e di që nëse nuk miratohet ligji, vlen ligji paraprak, derisa të miratohet i riu. Po ashtu, kërkoi nga z. Xheladin Hoxha, që të dërgohet sugjerimi për ndryshimin e nenit 24, me shkrim.

Pas diskutimeve dhe propozimit, kryetari konstatoi se komisioni, njëzëri, miratoi amendamentin që do të jetë i radhitur si amendamenti 6 në raport, me tekstin si vijon:

Amendamenti 6

Neni 24, ndryshohet me tekstin si vijon:

Neni 24

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me efekt financiar më 1 janar 2018.

Kryetari njoftoi anëtarët e komisionit se sot kemi pranuar një amendament nga deputeti Milaim Zeka, i cili është këtu dhe ia dha fjalën.

Milaim Zeka, amendamenti ka të bëjë me ndarjen e mjeteve për “Projektin e ish-Qendrës së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Likofc, Skenderaj”. Unë mendoj që vendi më i shenjtë, pas Prekazit, është Likofci dhe që 17 vite njerëzit vullnetarisht janë duke u kujdesur për këtë Qendër të Shtabit të UÇK-së.

Fatmir Gashi, tha se Ministria e Financave e mbështet këtë amendament dhe propozon që mjetet të merren nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

Kryetari pyeti deputetin Zeka: A mundemi që për këtë projekt të ndahen 50,000 euro për vitin 2018, ndërsa 50,000 euro tjera në rishikim të buxhetit? Pra, mjetet të merren nga buxheti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës. Amendamentin ta tërhiqni dhe ky ndryshim të kalojë si i komisionit, ndërsa në tabelën përmbledhëse, do të figurojë emri i juaj si propozues.

Milaim Zeka, theksoi se pajtohet me propozimin e kryetarit të komisionit.

Pas diskutimeve dhe propozimit, kryetari konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që në amendamentin 29 të komisionit, të shtohen dy pika, 1.5 dhe 1.6, me tekstin si vijon:

- 1.5. Nënprogrami “Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale e Kosovës”, me kod 27900, në tabelën 3.2, shtohet projekti i ri: “Projekti ish-Qendra e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në Likofc, Skenderaj”, në shumë prej 50,000 euro.
- 1.6. Nënprogrami “Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale e Kosovës”, me kod 27900, në tabelën 3.2, në projektin me kod 15391 “Kompleksi Memorial Demë Ahmeti, Podujevë”, në shumën prej 350,000 euro, ndryshohet në shumën prej 300,000 euro.

Më pas, kryetari konstatoi se komisioni, njëzëri, miratoi raportin final me amendamente për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe i njëjti procedohet për shqyrtim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 11:21.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit.

**Kryetari komisionit,
Lumir Abdixhiku**
